



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 911 / 3 Prot.

Tiranë, më 21 /09/2016

VENDIM

Nr. 64, datë 21/9 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/I të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 911 Prot., datë 01.09.2016, ndaj Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën nr. 025/16 Prot., datë 15.07.2016 ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë t’i vihet në dispozicion informacioni si më poshtë:

1. *Kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer nga KLSH “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën e aktivitetit Shtator 2006 deri me Shtator 2013, për Projektin “Modernizimi i sistemit shëndetësor Shqiptar” me objekt: “Mbi marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e saj nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit; Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit; Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disburseve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar.*
2. *Një kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që Ministria e Shëndetësisë ka raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur.*

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit. Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri me urdhrin Nr.190, datë 13.09.2016 urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Ministria e Shëndetësisë. Pranë këtij autoriteti u depozitua Urdhri i inspektimit administrativ dhe u protokollua me nr. 4609 Prot., datë 13.09.2016.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Qendrës “Res Publica” është depozituar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe është protokolluar me nr. 3855 Prot., datë 18.07.2016.

Lidhur me ankesën e Qendrës "Res Publica", u kontaktua me Koordinatorin e të Drejtës për Informim, i cili na sqaroi se: Dokumentacioni i kërkuar përbën informacion publik, në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku citohet se "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik, por kjo kërkesë nuk është trajtuar.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas konsultimit të legjislacionit, vlerëson se informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica" mbi raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik. Çdo autoritet publik, në kuptim të nenit 7, pika 1, shkronja dh) të Ligjit 119/2014, duhet të ketë publik në programin e transparencës mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga KLSH ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica" ndaj Ministrisë së Shëndetësisë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr. 911 Prot., datë 01.09.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Ministria e Shëndetësisë, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (Kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer nga KLSH "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare", për periudhën e aktivitetit Shtator 2006 deri me Shtator 2013, për Projektin "Modernizimi i sistemit shëndetësor Shqiptar" me objekt: "Mbi marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e saj nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit; Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit; Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar.), si edhe (Një kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që

Ministria e Shëndetësisë ka raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur) brenda datës 26.09.2016.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 21.9.2016.

